



Rreth kartes “pa Kontakt”

Q.1: Cilat janë karakteristikat e kartës “Pa Kontakt”?

Karta “Pa Kontakt” në plastikën e saj mbart shtesë një antenë e cila mundëson komunikim nëpërmjet valëve me terminalin PoS apo ATM gjithashtu të pajisur me antenë, pa qenë nevoja e futjes së kartës në lexuesin Chip / Shiritin Magnetik apo pa qenë nevoja e futjes së kodit PIN. Teknologjia “Pa Kontakt” nëpërmjet komunikimit NFC (komunikim në fushë nga afër) realizon leximin me sukses të të dhënave nga një largësi deri në 10 cm.

Q.2: Çfarë ndryshon krahasuar me kartën e mëparshme?

Ti shijon teknologjinë e kartës “Pa Kontakt” ndërsa karta mbart ende edhe tiparet e mëparshme, pra ju mund ta kaloni në lexuesin Chip apo Shirit Magnetik si nje kartë standarde.

Q.3: Cilat janë avantazhet e kartës “Pa Kontakt”?

Me kartën “Pa Kontakt” ti vepron shpejt, lehtë dhe në mënyrë të sigurt. Një transaksion “Pa Kontakt” dhe pa PIN zgjat mesatarisht vetëm 15 sekonda, ndërkohë transaksionet Cash zgjasin 34 sekonda dhe ato me Chip dhe PIN 25 sekonda.

Q.4: A mund të zgjedh të kem kartën pa tiparin “Pa Kontakt”?

Antena do të jetë tipari i përhershëm i kartës dhe nuk mund të çaktivizohet. Megjithatë, ti je i lirë të përdorësh kartën vetëm për të kryer transaksione me Chip të cilat do të kërkojnë të fusësh kodin PIN apo të kërkohësh të kesh limite për transaksione “Pa Kontakt” të ndryshme nga ato të caktuara.

Q.5: Çfarë do ndodhë kur karta ime e vjetër të skadojë?

Banka do të përgatisë për ju një kartë të rinovuar “Pa Kontakt”.

Q.6: A mund t’a ndërroj unë kartën time ekzistuese me një kartë “Pa kontakt”?

Nëse preferon, mund ti kërkohësh Bankës të ri-lëshojë një kartë “Pa Kontakt” dhe të mbyllësh kartën ekzistuese.

Përdorimi i kartes “Pa Kontakt”

Q.7: Ku mund të përdoret karta ime “Pa Kontakt”?

Kartat “Pa Kontakt” gjejnë përdorim të gjerë brenda dhe jashtë vendit kudo ku shfaqet në terminale shenja e valëve apo simboli WIFI.



Q.: Ç’do të ndodhë nëse terminali që pranon kartën nuk është terminal “Pa Kontakt”?

Karta do të vijojë të pranohet por duke e kaluar në lexuesin Chip si më parë.

Q.9: Çfarë ndodh nëse duhet të bëj një transaksion në internet?

Transaksionet “Pa Kontakt” mund të bëhen vetëm në терминаlet fizike, të cilat janë të aktivizuara “Pa Kontakt”. Transaksioni në internet do të vazhdojë të përpunohet në të njëjtën mënyrë si keni vepruar më parë i pandikuar nga ky tipar i ri i kartës.

Q.10: A do jenë të interesuar tregtarët t’a pranojnë kartën time?

Për tregtarin që pranon kartat “Pa Kontakt” për pagesa do të thotë më pak rradha, më pak para cash për të administruar dhe më shumë produktivitet për stafin shitës. Pra më tepër shitje në mallra dhe shërbime dhe si rrjedhojë më tepër të ardhura.

Q.11: Çfarë ndodh nëse kam përpara terminalit më shumë se një kartë “Pa Kontakt”?

Nëse prezanton përpara antenës në terminalin PoS, më shumë se një kartë “Pa Kontakt” në të njëjtën kohë, atëherë veprimi nuk do të kryhet derisa terminali të identifikojë prezencën e vetëm një karte.

Limitet “Pa Kontakt e pa PIN”

Q.12: Cila është shuma limit në kartën time për transaksionet “Pa Kontakt” pa PIN?

Krahas limitit kufi që ka çdo terminal, limit mbi të cilin transaksioni nuk mund të autorizohet pa verifikimin e PIN-it brenda dhe jashtë vendit, Banka Intesa Sanpaolo Bank Albania ka vendosur në çdo kartë një shumë limit ditor mbi të cilin do të duhet të vendosësh kodin PIN. Në varësi të monedhës së kartës ky limit ditor është 2,000 Lek, 20 Eur ose 20 USD.

Q.13: Sa transaksione “Pa Kontakt” mund të kryej në një ditë?

Mund të kryesh 2 transaksione “Pa Kontakt” dhe pa PIN në një ditë. Pas kësaj nëse dëshiron të kryesh më tepër transaksione në të njëjtën ditë do të duhet të kryesh të paktën një transaksion me kontakt me PIN (me dy faktorë) ose të prisësh ditën tjetër për të kryer dy transaksione të tjera.



Q.14: A mund të kem një limit të ndryshëm nga ai i caktuar nga banka?

Po, ti mund t'i kërkosh bankës të ndryshosh limitin e caktuar nga banka për transaksionet “Pa Kontakt” pa Pin për ta patur më të ulët ose më të lartë këtë limit ashtu sikurse mund të vendosësh edhe mbi frekuencën ditore të transaksioneve.

Q.15: Limitin “Pa Kontakt” e kam në nivel karte individuale apo klienti?

Nëse ke më shumë se një kartë “Pa Kontakt” mund të kryesh në ditë transaksione “Pa Kontakt” pa PIN me secilën nga kartat që ke.

Siguria

Q.16: Sa e sigurt është një kartë “Pa Kontakt” krahasuar me kartat e tjera?

Karta “Pa Kontakt” është e sigurt pasi ti e mban kartën përherë në dorën tënde dhe nuk ke nevojë ta dorëzosh atë tek persona të tretë për të përfunduar një transaksion. Platformat e teknologjisë “Pa Kontakt”, bazohen në teknologjinë e sigurtë të standarteve CHIP dhe ato të inkriptimit janë po aq të sigurta sa ato CHIP dhe PIN gjë që e bën pothuajse të pamundur vjedhjen e të dhënave në kartë.

Q.17: A rrezikoj kur kaloj me kartën time “Pa Kontakt” pranë ndonjë pajisje?

Teknologjia “Pa Kontakt” është projektuar për t'i siguruar kontrollin e duhur mbajtësit të kartës. Shitësi duhet të vendosë në terminal shumën e blerjes për aprovim dhe karta duhet të mbahet afër terminalit për të përfunduar një transaksion. Çdo komunikim midis kartës dhe terminalit në të njëjtën kohë krijon vetëm një transaksion dhe jo dublikatë. Gjithashtu, terminalët mund të përpunojnë vetëm një pagesë në të njëjtën kohë. Çdo transaksion “Pa Kontakt” gjeneron një kod unik që ndryshon në çdo blerje duke mos lejuar që karta e falsifikuar të riprodhohet me detajet e sigurisë së kartës së gjetur.

Q.18: Çfarë ndodh nëse karta ime vidhet apo humbet - a mund ta përdorë dikush në mënyrë të përsëritur?

Nëse PIN-i juaj nuk ka qenë i ekspozuar (vjedhur / humbur), keqpërdorimi është i kufizuar deri në 2 transaksione në ditë dhe në limitin total 2,000 Lekë, 20 Eur apo 20 USD në ditë. Në rastet e mundshme të mashtrimit, humbje apo vjedhje të kartës ju duhet të njoftoni menjëherë bankën për çdo përdorim të pa autorizuar të kartës apo ndonjë veprimtari të dyshimtë.